



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 24 regjistër (JR)  
Datë 25.10.2018

Nr. 4 i vendimit  
Datë 12.02.2019

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ina Rama</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Relatore</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Luan Daci</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 12.02.2019, ditën e martë, ora 10:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me sekretare gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket ankimit:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Gani Dizdari, gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 37, datë 16.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 63, 65 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi e bisedoi atë,

### **VËREN:**

#### **I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) me vendimin nr. 37, datë 16.07.2018, ka vendosur:
  - a) *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gani Dizdari, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.*
  - b) *Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.*
  - c) *Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*
2. Komisioni ka arritur në këtë përfundim, pasi ka administruar të tre raportet e vlerësimit: raportin përfundimtar të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), raportin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe raportin e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; si dhe provat e mbledhura për rivlerësimin e subjektit nga personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, shpjegimet e subjektit në pyetësorë, shpjegimet e personit të lidhur dhe të personave të tjerë të lidhur, provat e sjella prej tyre, si dhe thëniet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore nëpërmjet avokatit të tij.
3. Në përfundim, Komisioni, mbështetur në nenin 4, pika 2 të ligjit nr. 84/2016 e ka bazuar vendimin përfundimtar në vlerësimin e dy kriterëve, atë të vlerësimit pasuror dhe të figurës.
4. Lidhur me kriterin e pasurisë, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimeve për krijimin e pasurive si më poshtë:
  - i. Apartament banimi, me sipërfaqe 69.7 m<sup>2</sup>, ndodhur në adresën: Rr. “{\*\*\*}”, Pall. {\*\*\*}, Shk. {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}, Tiranë, ZK. {\*\*\*}, nr. Pasurie {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, fq 209;
  - ii. Depozitë në shumën 5272 euro;
  - iii. Shuma 23.000 euro, e dhënë nga z. G.L (ish-bashkëshorti i znj. A.D);
  - iv. Shuma 36.000 euro, hua nga z. Sh.D;
  - v. Shuma 20.000 euro, hua nga z. M.L;

- vi. 5 pagesa qiraje në shumën prej 600 euro, qira nga M.D.
  - vii. 14 pagesa qiraje në shumën prej 500 euro, qira nga shoqëria “{\*\*\*}” SHPK.
  - viii. Shuma 15.000 euro, shpenzime për mobilimin e apartamentit.
  - ix. Autoveturë e blerë për shumën 900.000 lekë.
5. *Për sa më sipër, Komisioni ka dalë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, shkak ligjor ky për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.*
6. *Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni ka konkluduar se, subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me shtetasin A.L/B, i cili cilësohet si person i përfshirë në krimin e organizuar, sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nr. {\*\*\*}, datë 22.06.2012, lënë në fuqi me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 08.04.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë, është dënuar me vendim të formës së prerë, për veprën penale të: “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1, paragrafi 2 i Kodit Penal, veprë e cila e kualifikon si person të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të nenit 3, pika 15 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Nga hetimi administrativ ka rezultuar që ndikimin e paligjshëm, shtetasi A.L, e ka ushtruar ndaj anëtarëve të Gjykatës së Lartë, në periudhën kur subjekti i rivlerësimit Gani Dizdari, ushtronte funksionin e gjyqtarit pranë kësaj gjykate. Nga hetimi administrativ, Komisionit i ka rezultuar që shtetasi A.L është dënuar për ndikim të paligjshëm ndaj vetë subjektit të rivlerësimit. Kjo lidhje e ngushtë që subjekti ka me këtë person, përbën rrethanë që merret parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm në kuptim të nenit 38, pika 4, germa “ç”, të ligjit nr. 84/2016. Për sa u përket rrethanave lehtësuese, ato mungojnë, sepse marrëdhënia familjare midis personave të mësipërm nuk është e largët dhe kontaktet familjare nuk janë të rralla.*
7. *Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit Gani Dizdari, ka pasur kontakte të papërshtatshme me një person të përfshirë në krimin e organizuar. Kjo përbën një problem serioz me figurën, çka bën të pamundur vazhdimin e detyrës dhe konstituon shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.*

## **II. Shkaqet e ankimit**

8. Kundër vendimit nr. 37, datë 16.07.2018 të Komisionit është ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim Kolegji) nga subjekti i rivlerësimit Gani Dizdari, i cili kërkon ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin në detyrë të tij, duke parashtruar këto shkaqe:
- i. *Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë - vendimi nr. 37, datë 16.07.2018 i Komisionit, është marrë në kundërshtim me parashikimet e nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk është marrë në konsideratë asnjë pretendim i subjektit të rivlerësimit, lidhur me pasuritë dhe burimin e tyre.*
  - ii. *Nuk është i drejtë arsyetimi i Komisionit lidhur me deklaramin e të ardhurave për vitet 1982-1993, kur konkludon për mospërbushje të detyrimit për të provuar ligjshmërinë e*

- burimeve*, pasi deklarimi i tyre ka qenë një lapsus për shkak të deklarimit të pagës në lekë të vjetër, ndaj kjo, nuk përbën fshehje apo justifikim të ndonjë shume të padeklaruar.
- iii. Komisioni ka qenë i njëanshëm dhe paragjykses, kur nuk ka marrë në konsideratë shpjegimet mbi përlllogaritjen e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit në shumën 2.391.593 lekë, duke mos përfshirë në analizën financiare, pagën e bashkëshortes nga viti 1985 deri në vitin 1993, marrëdhëniet e punës së të ndjerës, pa ndërprerje, nga viti 1998 – 2004, si dhe pagën e subjektit të rivlerësimit 1973-1982.
  - iv. Nuk është kryer asnjë hetim nga Komisioni mbi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk është vlerësuar drejt ligjshmëria e burimeve të krijimit të pasurisë, depozitë bankare pranë bankës “Credins” në vlerën 5.272 euro. Arsyetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri, bie në kundërshtim me nenin 49, pika 1, germa "b" dhe vijues të ligjit nr. 84/2016.
  - v. Komisioni ka gabuar kur konstaton mospërmbushje të detyrimit për të provuar ligjshmërinë e burimeve për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur, A.D, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 32 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, sepse përmbajtja e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 nuk ka asnjë lidhje me konceptin ligjor të “personit të lidhur”.
  - vi. Për pasurinë: "*Apartament banimi, me sipërfaqe 89.16 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “{\*\*\*}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit* ka paraqitur këto shpjegime në ankim:
    - a) Çmimi i apartamentit prej 94.000 euro sipas kontratës së porosisë të datës 19.11.2009, është paguar në dy këste, në vitin 2009 janë paguar 40.000 euro dhe në vitin 2010 54.000 euro. Këto pagesa kanë pasur si burim: 6.000 euro nga gjendja *cash* tërhequr nga banka, 5.000 euro nga babai, 36.000 euro hua pa interes nga kushëriri i saj Sh.D, sipas kontratës së huas së datës 19.11.2009, shumën prej 20.000 eurosh marrë hua pa interes nga kushëriri M.L, ndërsa shumën 23.000 euro nga ish-bashkëshorti, për të cilën, siç është deklaruar edhe më parë, nuk disponohen dokumente.
    - b) Huaja ndaj shtetasit M.L, fillimisht, është marrë pa asnjë dokument, por më pas, me kërkesën e tij është bërë deklaratë noteriale, më datë 25.07.2011, me nr. 4030 rep., nr. 1004 kol., e cila është deklaruar në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017.
    - c) Pas lidhjes së kontratës së porosisë për apartamentin me sipërfaqe 99 m<sup>2</sup> dhe pas likuidimit të shumës, personi i lidhur ka marrë pëlqimin e shoqërisë ndërtuese dhe të personit që kishte prenotuar apartamentin përballë, duke vendosur të bëhet shkëmbimi i pasurive me kontratën e shkëmbimit të datës 30.10.2013.
    - d) Sa i takon ndryshimit të sipërfaqes së apartamenteve nga kontrata e prenotimit tek ajo e shitjes, e për rrjedhojë edhe e çmimit, këtë e ka bërë vetë pala shitëse, pasi në kontratën e përfundimtare të shitjes nuk ka futur ambientet e përbashkëta.
    - e) Me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes, personit të lidhur i është kthyer diferenca mes çmimit të apartamentit të parashikuar në kontratën e shitblerjes me atë të të kontratës së porosisë, në vlerën 20.000 euro. Sasinë prej 15.000 euro nga kjo shumë, i ka shpenzuar menjëherë për pajisjen e shtëpisë dhe duke menduar se i ka deklaruar më

parë si shpenzim, në kuadër të vlerës 94.000 euro, nuk i ka deklaruar sërish.

- vii. Personi i lidhur, apartamentin e prenotuar e ka dhënë me qira me kontratën nr. 1283 rep., nr. 472 kol., datë 10.04.2012 dhe me kontratën nr. 1283 rep., nr. 472/3 kol., datë 03.06.2013, gjatë periudhës nga kontrata e porosisë, deri në atë të shitjes. Këto qira nuk janë deklaruar më parë për neglizhencë.
- viii. Lidhur me verifikimet dhe rezultatet e hetimit për Sh.D dhe M.L, aktiviteti i tyre ka ekzistuar edhe para vitit 2009. Rezulton se Sh.D, për vitin 1995 – 2007 ka paguar rregullisht detyrimet si avokat, ku vetëm në vitin 1996, ka derdhur tatim shumë 400.000 lekë, shumë që sipas ligjit për biznesin e vogël, përfaqëson 3% të të ardhurave, pra, bazuar në një përlllogaritje të thjeshtë, ai ka realizuar në këtë vit 13.300.000 lekë të ardhura. Ndërsa, M.L rezulton të jetë pronar i një lokali 4-katësh (hotel etj.) në qytetin e Fierit, me sipërfaqe 1050 m<sup>2</sup>, pronë e tij që prej vitit 2009.  
Përsa më sipër, ata i kanë pasur kushtet financiare për realizimin e huave të dhëna.
- ix. Automjeti tip “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*}, në zotërim të A.D është blerë në të njëjtën ditë dhe me të ardhura nga shitja e makinës tjetër, tip “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*} që ajo kishte në pronësi.
- x. Procesi i hetimit, gjykimit prej Komisionit ka qenë tërësisht i njëanshëm, i paragjykuar, i parregullt ligjor, si dhe në kundërshtim me parashikimin e nenit D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- xi. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni ka qenë i njëanshëm ose paragjykes dhe jo i saktë, kur konkludon se kontaktet me shtetasin (nipin) A.L përfshihen në kategorinë e të pasurit kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar, pasi referuar nenit 3, pika 8 dhe pika 15 të ligjit nr. 84/2016; si dhe nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 figura e veprës penale, për të cilën është dënuar ky shtetas, nuk përfshihet në kategorinë e personave të parashikuar në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, për pasojë, nuk ka ekzistuar detyrimi për të pasqyruar në deklaratën për kontrollin e figurës një moment që nuk parashikohet nga ligji.

### **III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

- 9. Subjekti i rivlerësimit Gani Dizdari, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe meqenëse ushtronte detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 4, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *me përparësi*.
- 10. Subjekti është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2006, me numër indeksi 7140 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. ILDKPKI, në përfundim të procedurës së plotë të kontrollit të pasurisë, ka përgatitur

raportin përkatës të paraqitur në Komision dhe, bazuar në nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit:

- i. ka bërë deklaram të saktë në përputhje me ligjin,
- ii. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë,
- iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë,
- iv. nuk ka kryer deklaram të rremë,
- v. nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

11. Sipas këtij raporti dhe dokumentacionit të përcjellë nga ILDKPKI pranë Komisionit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit Gani Dizdari ka deklaruar pasuri dhe të ardhura periodike, si më poshtë:

**Në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës të vitit 2006 ka deklaruar:**

**A. Pasuri:**

- i. Apartament banimi 2+1, nr. Pasurie {\*\*\*}, zona kadastrale {\*\*\*}, me sipërfaqe 95.7 m<sup>2</sup>, me adresë Rr. “{\*\*\*}”, Pall. 5, Shk. 2, Ap. 20, Tiranë, blerë 24.866 lekë me kontratën e datës 14.04.1994, në zbatim të ligjit mbi privatizimin. Pjesa që zotëron: 100%.
- ii. Apartament banimi 1+1, me sipërfaqe 69.7 m<sup>2</sup>, ndodhur në zonën kadastrale {\*\*\*}, blerë nga N. (O.) D. e R.D., në vlerën 1.850.000 lekë, me kontratën e shitblerjes nr. 433 rep., nr. 52 kol., datë 09.02.1998. Pjesa që zotëroj: 100%.
- iii. Depozitë bankare në ish-Bankën e Kursimit – sot “Raiffeisen Bank”, me kartelën {\*\*\*}, datë 20.07.1999, në momentin e krijimit - 60.000 lekë. Pjesa që zotëron: 100%.
- iv. Gjendja cash e krijuar nga kursimet jetësore të familjes si ish-prokuror, avokat etj., nga viti 1972 e në vazhdim - 4.600.000 lekë. Pjesa që zotëron: 100%.

**B. Të ardhurat:**

- i. Të ardhura nga paga neto në Gjykatën e Lartë, si anëtar i Gjykatës së Lartë, nga 17.02.2006, të kaluara në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank”, nr. i llogarisë {\*\*\*}, në vlerën 150.406 lekë.
- ii. Të ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme, si rezultat i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Lartë për pagim page, ekzekutuar më datë 23.02.2006, në llogarinë {\*\*\*} në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 414.720 lekë.
- iii. Të ardhura nga Gjykata e Rrethit Tiranë, rrjedhojë e punës si avokat në çështjet kryesisht në llogarinë {\*\*\*} në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 109.000 lekë.
- iv. Të ardhura nga avokatia, nga janari deri më 16.02.2006, në vlerën 210.000 lekë.

**C. Deklarimi i pasurive të personave të lidhur, vajza, A.D:**

- i. Depozitë bankare në Raiffeisen Bank në Tiranë, më datë 30.03.2006, me nr. kontrate 000261, në vlerën 11.000 euro. Depozitë e përbashkët me N. L. (kushërira). Depozitë e krijuar nga dhurata e prindërve, të dajave, tezeve etj. Pjesa që zotëron: 80%.

D. Të dhëna që nuk publikohen:

- i. Depozita bankare në ish-Bankën e Kursimit – sot “Raiffeisen Bank”, me kartelën {\*\*\*}, datë 20.07.1999, në momentin e krijimit - 60.000 lekë.

**Në deklaratën e pasurisë 2006 ka deklaruar:**

A. Pasuritë:

- i. Shtesë 1.060.000 lekë nga të ardhurat nga paga neto, shpërblimet dhe nga të ardhurat nga pjesëmarrja në Komisionin e Reformës Ligjore, pranë Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2006.
- ii. Pakësim në vlerën 300.000 lekë për blerje automjeti për vajzën, tip “Volkswagen”.
- iii. Të ardhura nga paga neto, si dhe shpërblimet për vitin 2006, në vlerën 1.382.551 lekë.

B. Të ardhurat:

- i. Të ardhura nga paga neto, si dhe shpërblimet për vitin 2006 në shumën 1.382.551 lekë.
- ii. Të ardhura nga pjesëmarrja si autor në Komisionin e Reformës Ligjore pranë Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2006, në vlerën 93.600 lekë.

C. Deklarimi i pasurive të personave të lidhur, vajza, A.D:

- i. Me kontratën e shitblerjes nr. 1536 rep., datë 19.04.2006 është blerë automjeti “Volkswagen” – 1J – “Golf” në vlerën 500.000 lekë, me kontributin e prindërve, dajës dhe tezeve.

**Në deklaratën e pasurisë 2007 ka deklaruar:**

A. Pasuri:

- i. Shtesa nga të ardhurat (paga neto) dhe nga të ardhurat e realizuara nga pjesëmarrja në Komisionin e Reformës Ligjore pranë Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2007, në vlerën 1.859.600 lekë. Pjesa që zotëron: 100%.
- ii. Shtesa nga paga e vajzës (A.D) për muajt nëntor - dhjetor 2007, si juriste në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në vlerën 67.027 lekë.
- iii. Pakësime për shpenzime personale e familjare për vitin 2007, në vlerën 560.000 lekë.
- iv. Nga vlera që ka disponuar, të cilën e ka deklaruar më parë në vitin 2006 dhe 2007, ka konvertuar në dollarë amerikanë vlerën 3.185.000 lekë, nga të cilat kanë rezultuar 35.000 dollarë amerikanë. Këtë shumë, 35.000 dollarë amerikanë, e ka depozituar në datën 09.07.2007 në agjencinë nr. 4 Tiranë – nr. 042001 “Raiffeisen Bank”, nr. llogarie {\*\*\*}.

B. Të ardhurat:

- i. Të ardhura nga paga neto, si dhe shpërblimet e dhëna nga institucioni (Gjykata e Lartë) për vitin 2007, në vlerën 1.648.600 lekë.
- ii. Të ardhura nga pjesëmarrja si anëtar i Komisionit/Grupit të Punës në Reformën Ligjore pranë Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2007, në vlerën 210.600 lekë.
- iii. Të ardhura nga paga e vajzës (A. D.) për muajt nëntor-dhjetor 2007, si juriste në Agjencinë

*e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në vlerën 67.027 lekë.*

*C. Deklarimi i pasurive dhe të ardhurave të personave të lidhur, vajza, A.D:*

- i. Të ardhura nga paga (neto) për muajt nëntor-dhjetor 2007, si juriste në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në vlerën 67.027 lekë.*

**Në deklaratën e pasurisë 2008 ka deklaruar:**

*A. Pasuritë:*

- i. Llogari rrjedhëse për pagën tek “Credins Bank”. Gjendja, më datë 31.12.2008 është 1.290.917 lekë.*

*B. Të ardhura:*

- i. Paga dhe shpërblime si gjyqtar në Gjykatën e Lartë në vlerën 1.692.834 lekë.*
- ii. Shpërblim nga Ministria e Drejtësisë si anëtar i Komisionit të Reformës Zgjedhore. Depozituar tek “Raiffeisen Bank” në vlerën 140.400 lekë.*

*C. Deklarimi i pasurive dhe të ardhurave të personave të lidhur, vajza, A.D:*

- i. Depozitë në “Raiffeisen Bank”, e deklaruar më parë në vlerën 10.300 euro.*
- ii. Shitur në vitin 2008, një autoveturë tip “Volkswagen” e deklaruar më parë, në vlerën 500.000 lekë.*
- iii. Blerë në vitin 2008, një autoveturë tip “Benz”, me të ardhurat e siguruar nga shitja e lartpërmendur dhe kursime, në vlerën 6174 euro.*
- iv. Të ardhura nga paga dhe shpërblime si specialiste në DP Tatim Taksa, në vlerën 38.400 lekë (1 muaj).*
- v. Të ardhura nga paga tek Zyra Qendrore e KKP në vlerën 50.000 lekë (1,5 muaj).*

*D. Të dhëna konfidenciale:*

- i. Marrë hua për prenotim apartamenti, nga kushëriri Sh.D, në shumën 36.000 euro pa interes, sipas kontratës nr. 6483 rep., nr. 1556 kol., datë 19.11.2009.*
- ii. Marrë hua për prenotim apartamenti, nga kushëriri M.L, në shumën 20.000 euro pa interes.*

**Në deklaratën e pasurisë 2009 ka deklaruar:**

*A. Pasuri:*

- i. Llogari rrjedhëse për pagën tek “Credins Bank”. Gjendja më datë 31.12.2009 është 1.230.000 lekë.*
- ii. Prenotim apartamenti 79 m<sup>2</sup>, i ndodhur në zonën “G” Gjiri i Lalëzit, me vlerë totale 3.600.000 lekë, paguar vlera prej 1.000.000 lekësh me pakësimin e gjendjes cash të deklaruar më parë.*
- iii. Blerje e një sipërfaqeje toke prej 1000 m<sup>2</sup> në fshatin Mjull, Bathore, në vlerën 344.000*



- lekë, me të ardhurat nga paga, sipas kontratës me nr. 42 rep., nr. 12 kol., datë 15.01.2009.
- iv. Shtuar gjendja cash për vitin 2009, në vlerën 8500 euro, me të ardhura në formën e dhuratës me rastin e martesës së vajzës.

**B. Të ardhurat:**

- i. Të ardhura nga paga si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, në vlerën 1.702.964 lekë.
- ii. Të ardhura në formën e dhuratës me rastin e martesës së vajzës, në vlerën 8500 euro.

**C. Detyrime financiare:**

- i. Detyrim ndaj firmës “{\*\*\*}” shpk për prenotim apartamenti me sipërfaqe 79 m<sup>2</sup>, me vlerë 3.600.000 lekë tek Gjiri i Lalëzit. Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, 1.000.000 lekë. Gjendja e detyrimit të mbetur pashlyer deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, 2.600.000 lekë.

**D. Deklarimi i pasurive, të ardhurave dhe detyrimeve të personave të lidhur, vajza, A.D:**

- i. Prenotim apartamenti 99 m<sup>2</sup>, i ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë me vlerë totale 94.000 Euro, paguar kësti 40.000 euro nga huaja e marrë nga kushëriri.
- ii. Të ardhura nga paga dhe shpërblime tek Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve [tri paga] mujore në vlerë 384.000 lekë x 3, më pas, leje lindjeje, në total, 115.200 lekë.
- iii. Të ardhura në formën e dhuratës për martesë, në vlerën 6800 euro.
- iv. Detyrim ndaj shoqërisë “{\*\*\*}” shpk për prenotim apartamenti me kontratë nr. 11028 rep., nr. 1521 kol., datë 19.11.2009. Shuma e shlyer 40.000 euro. Gjendja e detyrimit 54.000 euro.

**E. Të dhëna konfidenciale:**

- i. Marrë hua për prenotim apartamenti nga kushëriri Sh.D në shumën 36.000 euro pa interes, me kontratën nr. 6483 rep., nr. 1556 kol., datë 19.11.2009

**Në deklaratën e pasurisë 2010 ka deklaruar:**

**A. Pasuritë:**

- i. Llogari rrjedhëse për pagën tek “Credins Bank”. Gjendja, gjithsej, më datë 31.12.2010 është 1.830.000 lekë. Pjesa që zotëron: 100%.
- ii. Prenotim apartamenti 79 m<sup>2</sup>, i ndodhur në zonën “G” Gjiri i Lalëzit, me vlerë totale 3.600.000 lekë, paguar për vitin 2010, vlera prej 800.000 lekësh me pakësimin e gjendjes cash të deklaruar më parë. Pjesa që zotëron: 100%.
- iii. Gjendja cash në banesë: 39.500 dollarë amerikanë, krijuar si rezultat i tërheqjes nga llogaria bankare në “Raiffeisen Bank”, e deklaruar më parë dhe e mbyllur si llogari; vlera fillestare 35.000 dollarë amerikanë, interesat e përfituara: 4950 dollarë amerikanë. Pjesa që zotëron: 100%.
- iv. Gjendja cash në banesë - 39.500 dollarë amerikanë, të ardhura të siguruara nga mbyllja e llogarisë bankare tek “Raiffeisen Bank”. Pjesa që zotëron: 100%.
- v. Pakësimin e gjendjes cash të deklaruar më parë, në vlerën 5000 euro.

**B. Të ardhurat:**

- i. Të ardhura nga paga si gjyqtar në Gjykatën e Lartë në vlerën 1.697.128 lekë.

**C. Detyrime financiare:**

- i. Detyrim ndaj firmës “{\*\*\*}” shpk për prenotim apartamenti me sipërfaqe 79 m<sup>2</sup>, me vlerë 3.600.000 lekë te Gjiri i Lalëzit. Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, 800.000 lekë. Gjendja e detyrimit të mbetur pashlyer deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, 1.800.000 lekë.

**D. Të dhëna konfidenciale:**

- i. Shpenzime për kurim jashtë shtetit në Gjermani, në vlerën 10.270 euro, të mbuluara nga gjendja cash prej 8500 euro të deklaruar më parë dhe pjesa tjetër, nga gjendja cash në lekë të konvertuara në euro.
- ii. Dhuruar vajzës, vlera prej 5000 euro, nga pakësimi i gjendjes cash, për pagimin e kësteve të apartamentit.

**F. Deklarimi i pasurive dhe detyrimeve të personave të lidhur, vajza, A.D:**

- i. Prenotim apartamenti 99 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Rr. “{\*\*\*}”, Tiranë, me vlerë totale 94.000 euro, paguar kësti 54.000 euro për vitin 2010, nga të cilat, 23.000 euro nga bashkëshorti, 5000 euro nga babai, 6000 euro nga pakësimi i gjendjes cash të deklaruar më parë, dhe pjesa tjetër, huaja e marrë nga kushëriri.
- ii. Detyrim ndaj shoqërisë “{\*\*\*}” shpk për prenotim apartamenti me kontratë nr. 11028 rep., nr. 1521 kol., datë 19.11.2009. Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm 54.000 euro. Gjendja e detyrimit: likuiduar.

**G. Të dhëna konfidenciale:**

- i. Marrë hua për prenotim apartamenti nga kushëriri Sh.D., në shumën 36.000 euro pa interes, me kontratën nr. 6483 rep., nr. 1556 kol., datë 19.11.2009.
- ii. Marrë hua për prenotim apartamenti nga kushëriri M.L, në shumën 20.000 euro pa interes.

**Në deklaratën e pasurisë 2011, ka deklaruar:**

**A. Pasuritë:**

- i. Më datën 30.06.2011 kaluar nga llogaria në Bankën “Credins” dega Tirana 2, (të ardhura nga paga) në depozitë shuma prej 1.500.000 lekë, me afat një vjeçar, me interes 6,5%, me nr. depozite {\*\*\*}.

**B. Të ardhurat:**

- i. Të ardhura nga paga si gjyqtar në Gjykatën e Lartë në vlerën 1.672.507 lekë.

**C. Detyrime financiare:**

- i. Detyrim ndaj firmës “{\*\*\*}” shpk për prenotim apartamenti, me vlerë 3.600.000 lekë tek Gjiri i Lalëzit. Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të

deklarimit, 800.000 lekë. Gjendja e detyrimit të mbetur pashlyer deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, 1.000.000 lekë.

D. Të dhëna konfidenciale:

- i. Më datë 07.09.2011 është çelur depozitë tek Banka "Credins" në vlerën 50 Euro. Në këtë depozitë janë derdhur nga banka ORD. UNIVERSITAETSKLINIKUM TRN NO. E01-11000088624, shuma 3523 euro nga mbyllja e llogarisë për kurim jashtë shtetit të deklaruar më parë.

E. Deklarimi i të ardhurave të personave të lidhur, vajza, A.D:

- i. Të ardhura nga paga dhe shpërblime të bashkëshortit në OST Tiranë, në vlerën 840.000 lekë.

**Në deklaratën e pasurisë 2012 ka deklaruar:**

A. Pasuritë:

- i. Llogari rrjedhëse për pagën Credins Bank. Gjendja më datë 31.12.2012 është ---. (Shënim: në deklaratën e subjektit, nuk është vendosur shuma)
- ii. Shtuar gjendja cash në banesë dhe në llogari rrjedhëse për vitin 2012, në vlerën 1.250.000 lekë.

B. Të ardhurat:

- i. Të ardhura nga paga si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, në vlerën 1.680.672 lekë, sipas vërtetimit të datës 29.03.2013.

C. Detyrime financiare:

- i. Detyrim ndaj firmës "{\*\*\*}" shpk për prenotim apartamenti, me vlerë 3.600.000 lekë tek Gjiri i Lalëzit, paguar me të ardhura nga paga. Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, 0 lekë. Gjendja e detyrimit të mbetur pashlyer deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, 1.000.000 lekë.

D. Të dhëna konfidenciale:

- i. Më datë 07.09.2011 është çelur depozitë tek Banka "Credins" në vlerën 50 euro. Në këtë depozitë janë derdhur nga banka ORD. UNIVERSITAETSKLINIKUM TRN NO. {\*\*\*}, shuma 3523 euro nga mbyllja e llogarisë për kurim jashtë shtetit, e deklaruar më parë.

E. Deklarimi i të ardhurave të personave të lidhur, vajza, A.D:

- i. Të ardhura nga paga dhe shpërblime INSIG, në vlerën 840.000 lekë.
- ii. Të ardhura nga paga dhe shpërblime të bashkëshortit në OST Tiranë, në vlerën 214.600 lekë.

**Në deklaratën e pasurisë 2013 ka deklaruar:**

A. Pasuritë:

- i. Llogari rrjedhëse për pagën BKT Bank. Gjendja më datë 31.12.2013 është ---.(Shënim: në deklaratën e subjektit, nuk është vendosur shuma)
- ii. Me kontratën e depozitimit datë 05.07.2013, me nr. depozite 474677 në Credins Bank është depozituar shuma 5000 euro, nga të cilat 3547 euro kanë qenë gjendje në llogarinë rrjedhëse në këtë bankë, të cilat janë deklaruar më parë, ndërsa shuma prej 1453 eurosh, është derdhur cash nga të ardhurat që kanë qenë gjendje.

**B. Të ardhurat:**

- i. Të ardhura nga paga si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, në vlerën 456.205 lekë, sipas vërtetimit të datës 24.03.2014.
- ii. Të ardhura nga paga në detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, në vlerën 1.491.636 lekë, sipas vërtetimit të datës 04.03.2014.

**C. Detyrime financiare:**

- i. Detyrimi për prenotimin e apartamentit, të ndodhur në zonën "G" tek Gjiri i Lalëzit. E deklaruar më parë dhe përfundimisht, me kontratën e shitblerjes me nr. 1141 rep., nr. 707/3 kol., datë 15.11.2013 ka kaluar në pasuri të paluajtshme të subjektit për vlerën 3.300.000 lekë. Shuma e shlyer sipas deklarimeve të mëparshme ka qenë 2.600.000 lekë. Shuma e mbetur prej 700.000 lekë është likuiduar plotësisht ditën e nënshkrimit të kontratës. Në kontratën e porosisë së deklaruar më parë, apartamenti është deklaruar me sipërfaqe 79 m<sup>2</sup> së bashku me pjesët e përbashkëta, ndërsa në kontratën e shitblerjes, të regjistruar në hipotekë në bazë të çertifikatës së pronësisë, datë 11.12.2013, është me sipërfaqe 63.08 m<sup>2</sup>, prandaj çmimi përfundimtar është 3.300.000 lekë.

**D. Deklarimi i të ardhurave të personave të lidhur, vajza, A.D:**

- i. Të ardhura si Notere e Dhomës së Noterisë Tiranë për periudhën nga 01.09.2013 deri më datë 31.12.2013, në vlerën 500.000 lekë.

**Në deklaratën e pasurisë 2014 ka deklaruar:**

**A. Të ardhurat:**

- i. Të ardhura nga paga neto në detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, në vlerën 1.896.470 lekë.

**B. Deklarimi i të ardhurave të personave të lidhur, vajza, A.D:**

- i. Të ardhura si notere e Dhomës së Noterisë Tiranë, për periudhën nga 01.01.2014 deri më datë 31.12.2014, në vlerën 301.304 lekë.

**C. Deklarimi i pasurive të personave të lidhur, bashkëjetuesja, Sh. K.:**

- i. Pasuri (në lekë), në vlerën 1.415.000 lekë, e krijuar nga të ardhurat nga paga si arsimtare nga viti 1997 deri në vitin 2012, nga puna e përkohshme në INSTAT, qarku i Kukësit dhe pjesërisht, kontribut nga vëllezërit. Pjesa që zotëron: 100%.
- ii. Nga këto, e depozituar në "Raiffeisen Bank", me numër llogarie {\*\*\*}, vlera prej 135.000 lekë.
- iii. Gjendje cash - 1.280.000 lekë.

**Në deklaratën e pasurisë 2015 ka deklaruar:**

**A. Të ardhurat:**

- i. Të ardhura nga paga neto në detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, në vlerën 1.874.538 lekë.

**B. Deklarimi i të ardhurave të personave të lidhur, vajza, A.D:**

- i. Të ardhura si notere e Dhomës së Noterisë Tiranë, për periudhën nga 01.01.2014 deri më

datë 31.12.2015, në vlerën 401.304 lekë.

C. Deklarimi i pasurive të personave të lidhur, bashkëjetuesja, Sh. K.:

- i. Pasuri (në lekë), në vlerën 1.415.000 lekë, e krijuar nga të ardhurat nga paga si arsimtare nga viti 1997 deri në vitin 2012, nga puna e përkohshme në INSTAT, qarku i Kukësit dhe pjesërisht, kontribut nga vëllezërit. Pjesa që zotëron: 100%.
- ii. Nga këto, e depozituar në Raiffeisen Bank, me numër llogarie {\*\*\*}, vlera prej 135.000 lekësh.
- iii. Gjendje cash, 1.280.000 lekë.

**Në deklaratën e pasurisë 2016 ka deklaruar:**

A. Pasuritë:

- i. Më datë 28.12.2016 është depozituar në “Credins Bank”, dega Tiranë, shuma prej 8000 dollarësh amerikanë, sasi e mbajtur cash që nga mbyllja e llogarisë bankare tek “Raiffeisen Bank” në shumën 39.950 dollarë amerikanë (deklaruar më parë, më datë 30.03.2011).

B. Të ardhurat:

- i. Të ardhura nga paga si anëtar në Gjykatën Kushtetuese për vitin 2016, në vlerën 1.861.308 lekë.
- ii. Më datë 28.12.2016, në “Bankën Kombëtare Tregtare” (BKT) kanë mbetur gjendje 1.655.574 lekë të derdhura nga paga në vitet e mëparshme dhe në vazhdim dhe të pa tërhequra.

C. Deklarimi i të ardhurave të personave të lidhur, vajza, A.D:

- i. Të ardhura si notere e Dhomës së Noterisë Tiranë, për periudhën nga 01.01.2016 deri më datë 31.12.2016, në vlerën 830.873 lekë.

Deklarimi i pasurive të personave të lidhur, bashkëjetuesja, Sh. K.:

- i. Nuk ka ndryshime.

**Në deklaratën e pasurisë (vetting) 2017 ka deklaruar:**

A. Pasuri:

- i. Apartament banimi me sipërfaqe 95.7 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “{\*\*\*}”, Pal. 5, Shk. 2, Ap. 20, Tiranë, regjistruar në ZK. {\*\*\*}, Nr. Pasurie {\*\*\*}, vol 11, fq. 208. Blerë në vlerën 24.826 lekë në bazë të ligjit mbi privatizimin e banesave shtetërore, me kontratën datë 14.04.1994 nga Ndërmarrja Komonale Banesa Tiranë. Kjo kontratë është noterizuar me nr. 2904 rep., nr. 478 kol., datë 26.04.1994. Pas vdekjes së bashkëshortes D. D. në vitin 2004, në zbatim të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 06.03.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, subjekti ka  $\frac{3}{4}$  (75%) të apartamentit, ndërsa vajza e tij, e ndarë nga ai, ka në pronësi  $\frac{1}{4}$  (25%).

- ii. Apartament banimi me sipërfaqe 69.7 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. "{\*\*\*}", pal. 5, shk. 2, ap. 21, Tiranë. Regjistruar në Zonën Kadastrale {\*\*\*}, Nr. Pasurie {\*\*\*}, vol. 11, fq. 209. Blerë me kontratën e shitblerjes Nr. 52 rep., nr. 433 kol., datë 09.02.1998, nga bashkëshortja e ndjerë në vlerën 1.850.000 lekë. Pas vdekjes së bashkëpronares, (bashkëshortes), në zbatim të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 06.03.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, subjekti ka në pronësi ½ pjesë (50%) të apartamentit, ndërsa vajza e tij A.D (e ndarë nga ai) ka ½ pjesë (50%) të apartamentit.
- iii. Apartament banimi, ndodhur tek Gjiri i Lalëzit, me sipërfaqe 63.08 m<sup>2</sup> (sipërfaqe shkalle 7 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ballkoni 16.78 m<sup>2</sup>), regjistruar në Zonën Kadastrale nr. 2375, Nr. Pasurie {\*\*\*}, vol. 8, fq 119, blerë me kontratën nr. 1141 rep., nr. 707/3 kol., datë 15.11.2013 në shumën 3.300.000 lekë.
- iv. Tokë arë e ndodhur në Fshatin Mjull, Bathore, Tiranë, me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Zonën Kadastrale {\*\*\*}, Nr. Pasurie {\*\*\*}, vol. 18, fq. 74. Blerë me kontratën nr. 12 rep., nr. 12 kol., datë 15.01.2009 në shumën 344.000 lekë.
- v. Më datë 30.06.2011 është depozituar në bankën "Credins", dega Tirana 2, shuma 1.500.000 lekë (të cilat ishin gjendje në këtë bankë, si rezultat i mostërheqjes së të gjithë pagës për vitet 2006-2011). Duke shtuar interesat bankare më datë 28.12.2016, kjo shumë ka arritur në vlerën 1.843.006 lekë.
- vi. Më datë 09.07.2007 është depozituar në "Raiffeisen Bank", dega Rr. {\*\*\*}, Tiranë, shuma 35.000 dollarë amerikanë. Më datë 13.07.2010 është tërhequr kjo shumë, e cila në këtë moment si rezultat i interesave bankare, kishte arritur në shumën 39.966 dollarë amerikanë. Nga kjo sasi, rreth 25.000 dollarë amerikanë janë harxhuar për rikonstruktimin dhe pajisjen e banesës, apartamentit të deklaruar më sipër në Rr. "{\*\*\*}", Pall. 5, Shk. 2, Tiranë.
- vii. Më datë 07.09.2011, është hapur depozitë në Bankën "Credins", dega Tirana 2, ku janë derdhur 50 euro. Në këtë depozitë është derdhur nga Banka ORDUNIVERSITAETSKLINIKUM Hamburg, Gjermani, shuma prej 3523 Euro, si rezultat i kthimit nga mbyllja e llogarisë për kurimin në spital. Ndërsa, më datë 05.07.2013, është derdhur në këtë llogari edhe shuma 1453 euro duke arritur përfundimisht në 5000 euro gjithsej. Më datë 28.12.2016, si rezultat i interesave bankare, kjo shumë ka arritur në 5272 euro. Pjesa që zotëron: 100%.
- viii. Më datë 22.07.1999 është depozituar shuma 60.000 lekë në ish-Bankën e Kursimeve Tiranë, Rr. {\*\*\*}, Nr. Kartelës 46206/15, shumë kjo që sot ka kaluar depozitë në llogarinë e Raiffeisen Bank. Pjesa që zotëron: 100%.
- ix. Më datë 28.12.2016 është depozituar në Bankën "Credins", dega Tirana 2, shuma prej 8000 dollarësh amerikanë, sasi e mbajtur cash që nga tërheqja e deklaruar më lart nga "Raiffeisen Bank" (datë 13.07.2010). Pjesa që zotëron: 100%.
- x. Më datë 28.12.2016, në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT) dega Piazza, Tiranë, ka mbetur gjendje shuma 1.655.574 lekë të derdhura nga paga dhe të patërhequra. Pjesa që zotëron: 100%.

B. Të ardhurat:

- i. Nga marsi i vitit 1973-1982, si rezultat i punës në Prokurorinë e Rrethit Tropojë, me detyrë prokuror sektori, me pagë 7000 lekë në muaj (paga e kohës), janë siguruar 7560 lekë. Nuk disponohet dokumentacion për këtë, nga ky organ.
- ii. Nga viti 1982 – 1994, nga puna në Prokurorinë e Përgjithshme, nga paga, është siguruar shuma 1.138.320 lekë.
- iii. Nga viti 1994 – 1999, nga puna në Prokurorinë e Përgjithshme (prokuror pranë Gjykatës së Lartë dhe Zv.Prokuror i Përgjithshëm), është siguruar nga paga, shuma 1.951.634 lekë.
- iv. Nga viti 1999 – 2000 është trajtuar me pagë kalimtare nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë, në shumën 307.200 lekë.
- v. Nga viti 2000 – 2005, nga puna si avokat, ka siguruar 8.633.000 lekë. Kjo shumë nuk del e saktë nga dokumentet që disponon organi i tatimeve, pasi për vitin 2004, dhe pse ka vazhduar punën, nuk figurojnë të dhëna.
- vi. Gjatë periudhës 2000 – 2005, nga puna si avokat kryesisht, në Gjykatën e Rrethit Tiranë, ka siguruar shumën 104.640 lekë. Kjo shumë nuk është evidentuar nga tatimet, pasi është tërhequr në vitin 2006 nga Gjykata e Rrethit.
- vii. Si rezultat i ekzekutimit të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 22.04.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ka kaluar në llogarinë bankare të subjektit nga Prokuroria e Përgjithshme, me urdhër pagesë nr. 53, datë 23.02.2006, shuma 414.720 lekë.
- viii. Nga paga e bashkëshortes së ndjerë, D. D., për periudhën 1994 – 2004, është siguruar shuma 1.212.920 lekë.
- ix. Nga paga si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, për periudhën 2006 – 2013 janë siguruar 11.834.461 lekë.
- x. Në vitet 2006 – 2008, si rezultat i pjesëmarrjes në Komisionin e Reformës Ligjore pranë Ministrisë së Drejtësisë, ka siguruar shumën 444.600 lekë.
- xi. Në vitin 2009, me rastin e martesës së vajzës, A.D, është sjellë në formë dhurate, nga të ftuarit në koktej, darkë etj., shuma prej 8500 eurosh.
- xii. Nga paga si anëtar i Gjykatës Kushtetuese për vitin 2013 – 2016, ka siguruar shumën 7.123.952 lekë.

C. Deklarimi i pasurive, të ardhurave dhe detyrimeve të personave të lidhur, vajza, A.D:

- i. Me kontratën e shitblerjes nr. 5403 rep., nr. 2249 kol., datë 13.11.2013, ka blerë një apartament banimi në Rr. “{\*\*\*}”, shkalla 1, kati 2, Ap. 7, Tiranë, me sipërfaqe 89.16 m<sup>2</sup>, Zonë Kadastrale 8150, nr. pasurie 6/130+1-7, vol 49, f. 162, blerë nga shoqëria “{\*\*\*}” SHPK në shumën 73.111 euro. Pjesa që zotëron: 100%.
- ii. Bashkëpronare në ¼ pjesë (25%) me sipërfaqe 95.7 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “{\*\*\*}”, pall. 5, shk. 2, ap. 20, Tiranë, regjistruar në Zonën Kadastrale {\*\*\*}, Nr. Pasurie {\*\*\*}, vol 11, fq. 208. Përfutuar nga çelja e dëshmisë së trashëgimisë ligjore sipas vendimit nr. {\*\*\*}, datë 06.03.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- iii. Bashkëpronare në ½ pjesë (50%) me sipërfaqe 69.7 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “{\*\*\*}”, pall. 5,

- shk. 2, ap. 21, Tiranë, regjistruar në Zonën Kadastrale {\*\*\*}, nr. Pasurie {\*\*\*}, vol 11, fq. 209. Përfitur nga çelja e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, sipas vendimit nr. {\*\*\*}, datë 06.03.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- iv. Me kontratën e blerjes nr. 918 rep., nr. 843 kol., datë 03.04.2013 ka blerë autoveturën marka Mercedes Benz në shumën 900.000 lekë, të siguruara nga konvertimi i makinës së mëparshme Mercedes Benz në shumën 6000 euro, duke i shtuar dhe shumën plotësuese të kontratës. Pjesa që zotëron: 100%.
  - v. Nga data 01.11.2008 – 01.04.201 (dyqind e një e ka shkruar personi i lidhur i subjektit – nuk mund të identifikohet viti) ka siguruar nga puna në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve shumën 200.346 lekë.
  - vi. Për periudhën nga data 12.01.2012 – 06.06.2012 nga puna në INSIG sha, ka siguruar shumën 162.986 lekë.
  - vii. Për periudhën 2013 – 2015 nga puna si notere, person fizik e regjistruar me NIPT {\*\*\*}, është përfitur shuma prej 2.710.009 lekë.

D. Të dhëna konfidenciale të personit të lidhur, vajza A. D:

- i. Me kontratën nr. 6483 rep., nr. 1556 kol., datë 19.11.2009, ka marrë hua nga Sh.D (kushëriri im), shumën 36.000 euro, pa interes. E palikuiduar.
- ii. Ka marrë hua në vitin 2009 nga M.L (kushëriri), shumën 20.000 euro, pa interes. E palikuiduar.

E. Deklarimi i pasurive, të ardhurave dhe detyrimeve të personave të lidhur, bashkëjetuesja, Sh. K..

- i. Në Bankën Raiffeisen, agjencia Tropojë, ka depozituar shumën 135.048 lekë, si rezultat i të ardhurave nga paga si mësuese.
- ii. Gjendje në cash 1.280.000 lekë, nga të ardhurat nga paga si mësuese, për periudhën 1999 – 2013, nga puna e përkohshme në INSTAT, dega Tropojë, dhe nga dhurimi i vëllezërve dhe nipave.
- iii. Për periudhën 01.01.1999 – 30.09.2007, nga paga si mësuese në shkollën 9-vjeçare “Kovaç”, Tropojë, si dhe në shkollën “Ali Ibër Nezaj”, Tropojë, ka siguruar shumën 630.703 lekë.
- iv. Për periudhën 01.01.2009 – 30.07.2013, në shkollat e mësipërme, ka siguruar shumën 291.697 lekë.
- v. Nga puna në INSTAT, dega Tropojë, duke punuar me kohë të pjesshme në periudhën tetor 2010 – tetor 2011, ka siguruar shumën 85.000 lekë dhe 350 euro. Nuk ka mundur të siguroj dokumentin përkatës dhe është në pritje të përgjigjes, sepse kjo degë është shkrirë.

12. Nisur nga aktet shkresore që janë administruar në dosje, si dhe shkaqet në ankim të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupit gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, bazuar në nenin “D”, pika 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016, kryen kontrollin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit,



personin e lidhur dhe të personave të tjerë të lidhur, në përputhje me kriteret që parashikojnë dispozitat e mësipërme.

**13. Për pasurinë:**

1. *Apartament banimi, me sipërfaqe 69.7 m<sup>2</sup>, ndodhur në adresën: Rr. “{\*\*\*}”, Pall. 5, Shk. 2, Ap. 21, Tiranë, Zona Kadastrale {\*\*\*}, nr. pasurisë {\*\*\*}, Vol. 11, Fq. 209. Deklaruesi zotëron 50% të kësaj pasurie, sipas deklaratës së pasurisë (vetting) 2017. Kjo pasuri është blerë me kontratën nr. 433 rep., nr. 52 kol., datë 09.02.1998, në vlerën 1.850.000 lekë, nga D. D. (bashkëshortja e ndjerë e subjektit).*

14. Subjekti i rivlerësimit, këtë pasuri/apartament e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën e pasurisë së vitit 2006, si të blerë përmes kontratës së shitblerjes nr. 433 rep, nr. 52 kol., datë 09.02.1998, në vlerën 1.850.000 lekë, me pjesë takuese 100%. Në deklaratën e pasurisë 2006 nuk ka deklaruar burim krijimi.

15. Edhe në deklaratën e pasurisë (vetting) 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartamentin si të blerë përmes kontratës së shitblerjes nr. 433 rep., nr. 52 kol., datë 09.02.1998, në vlerën 1.850.000 lekë, nga D. D.(bashkëshortja e ndjerë e subjektit të rivlerësimit) dhe si pjesë takuese, pas vdekjes së bashkëshortes, 50%, ndërsa pjesën tjetër, si pjesë takuese të vajzës së tij, A.D, përkatësisht 50% të vlerës së këtij apartamenti. Në deklaratën e pasurisë vetting 2017, subjekti i rivlerësimit, sërish, nuk ka përcaktuar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

16. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi provat e gjendura në dosjen e gjykimit për këtë pasuri, referuar edhe analizës financiare të kryer në Kolegji, arrin në përfundimin se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, nga viti 1973 deri në vitin 1998, janë në vlerën 2.526.669,72 lekë. Në vitin 1998, subjekti kishte dy apartamente në pronësi, së bashku me personin e lidhur, bashkëshorten e ndjerë, D. D. dhe vlera e tyre ishte 1.874.826 lekë.

17. Për të arritur në përfundimet si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit administroi në cilësinë e provës edhe vërtetimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë, me nr. extra prot., datë 21.10.2016, në të cilin vërtetohet se subjekti ka qenë me detyrë prokuror, pa ndërpreje pranë kësaj prokurorie, për periudhën 1973 deri në vitin 1982, si edhe, se për këtë periudhë nuk gjenden dokumente për të vërtetuar të ardhurat e subjektit, pasi ato janë djegur në trazirat e vitit 1997. Për të përlogaritur të ardhurat e subjektit për këtë periudhë, trupi gjykues i është referuar pagave të referencës.

18. Nga analiza financiare e kryer për subjektin e rivlerësimit, duke përlogaritur edhe standardin e jetesës, inflacionin e lekut në vitin 1992, i cili ishte 236%, vlerën prej 1.874.826 lekësh të dy apartamenteve në pronësi deri në vitin 1998, trupi gjykues i Kolegjit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk krijon bindjen se ka pasur të ardhura për të justifikuar blerjen e apartamentit me sipërfaqe 69.7 m<sup>2</sup>, ndodhur në adresën: Rr. “{\*\*\*}”, Pall. 5, Shk. 2, Ap. 21, Tiranë, Zona Kadastrale {\*\*\*}, nr. pasurisë {\*\*\*}+2-21, Vol. 11, Fq. 209.

19. Pretendimin e subjektit se dispononte vlerën 2.000 dollarë për blerjen e këtij apartamenti, trupi gjykues i Kolegjit nuk e merr në konsideratë, pasi subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë provë për ta vërtetuar këtë fakt dhe pretendimi i tij, mbeti në nivel deklarativ.

20. *Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimi të ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie, si dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me burimet e të ardhurave, me të cilat është blerë kjo pasuri e paluajtshme, sipas parashikimeve të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.*
21. Nisur nga shkaqet e parashtruara në ankim nga subjekti i rivlerësimit, për mënyrën e përllogaritjes së të ardhurave të ligjshme të tij, trupi gjykues i Kolegjit administroi në kuptim të nenit 32, pika 2 të ligjit nr. 84/2016 vërtetimin me nr. extra prot., të datës 21.10.2016 të Prokurorisë së Rrethit Tropojë, duke marrë në konsideratë të ardhurat e pagës që pretendon subjekti për vitet 1973-1982, si edhe vërtetimin nr. 25/2 prot, datë 25.06.2018 të Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë. Vërtetimi i Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë dokumenton faktin se bashkëshortja e ndjerë e subjektit të rivlerësimit ka punuar pranë këtij institucioni si infermiere në vitet 1985 - 2004, por nuk jep detaje për pagën e bashkëshortes së ndjerë të subjektit për vitet 1985 - 1993. Trupi gjykues i Kolegjit, duke vlerësuar pamundësinë objektive të subjektit të rivlerësimit për të gjetur këto të dhëna mbi të ardhurat nga paga të bashkëshortes së ndjerë, në bazë të nenit 32, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, e gjen me vend t'i përllogarisë ato sipas pagës që ajo ka pasur në vitin vijues, 1995. Edhe pas pasqyrimit të këtyre të ardhurave në përllogaritje, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit (dhe ato të bashkëshortes) rezultojnë të pamjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti, pas zbritjes së shpenzimeve të jetesës, por edhe duke marrë parasysh shkallën e inflacionit të viteve 1992-1994, si dhe ndryshimet ekonomike të kohës që kanë pasqyruar efektet përkatëse, si në ekonominë e tregut, ashtu dhe atë familjare.
22. Sa më sipër, u bazua në aktet shkresore të administruara, si më poshtë:
- i. Kontratë shitblerje nr. 433 rep., nr. 52 kol., datë 09.02.1998, për apartamentin me sipërfaqe 69.7 m<sup>2</sup>, blerë nga bashkëshortja e ndjerë e subjektit të rivlerësimit, D. D., në shumën 1.850.000 lekë;
  - ii. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. {\*\*\*}, datë 06.03.2007, me objekt: “Për çeljen e dëshmisë së trashëgimisë;
  - iii. Vërtetim lëshuar nga ZVRPP Tiranë, me nr. 10107 prot., datë 07.12.2016;
  - iv. Certifikatë për vërtetim pronësie, më datë 05.06.2007, për apartamentin me sipërfaqe 69.7 m<sup>2</sup>.
  - v. Shkresë me nr. 44777/1 prot., datë 29.12.2017 e ZVRPP Tiranë, e cila konfirmon bashkëpronësinë e subjektit të rivlerësimit, z. Gani Dizdari me znj. A.D, për pasurinë me nr. {\*\*\*}+2-21, Vol. 11, Fq. 209, lloji i pasurisë: apartament, me sipërfaqe. 69.7 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “{\*\*\*}”, Pl. 5, Shk. 2, Ap. 21, Tiranë;
  - vi. Shkresë nr. 924/1 prot., datë 12.01.2018 e OSHEE, e cila referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikon se në emër të shtetasit Gani Dizdari, rezultojnë 2 (dy) kontrata për faturim me energji elektrike, njëra prej të cilave është për apartamentin me adresë: Rr. “{\*\*\*}”, Pl. 5, Shk. 2, Ap. 21, Tiranë, me status “Kontratë Aktive”, me datë hapje 10.10.1997.
  - vii. Shkresë me nr. K-278/1 prot., datë 06.02.2018 e UKT, e cila nuk konfirmon asnjë kontratë për furnizim, në emër të subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri.
  - viii. Vërtetim i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë datë 21.10.2016.
  - ix. Vërtetim nr. 25/2 prot, 25.06.2018 i Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë.

- x. Përgjigje/shpjegime të pyetësorit të dhënë nga subjekti me nr. 5053 prot., datë 04.07.2018.

23. **Për pasurinë:**

2. Depozitë në shumën 5.272 euro në “Credins Bank”.
24. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit, më datë 07.09.2011, ka hapur një depozitë në bankën “Credins” me vlerën 50 euro. Në këtë depozitë është derdhur më datë 28.09.2011, shuma prej 3.523 eurosh, me përshkrimin "Transfertë me/nga banka të tjera", me urdhërues “ORD UNIVERSITAEKLINIKUM” Hamburg, Gjermani. Në këtë depozitë, subjekti i rivlerësimit ka shtuar dhe shumën 1.453 euro (totali 5000 euro) dhe së bashku me interesat, shuma shkon 5.272 euro. Depozita zotërohet 100% nga subjekti. Kjo provohet me dokumentin shkresor, nxjerrje e llogarisë bankare (*statement* bankar) nga banka "Credins", e datës 28.12.2016, e administruar në dosjen e gjykimit.
25. Referuar deklaratës së pasurisë së vitit 2010, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën "Të dhëna konfidenciale", ka deklaruar se ka shpenzuar vlerën 10.270 euro për kurim në Gjermani. Në përgjigjet e pyetësorit të Komisionit, i cili mban datën 04.07.2018, me nr. 5053 prot., rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar që shpenzimet për kurim në Gjermani, kanë qenë në vlerën 15.000 euro.
26. Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë dy deklarime të ndryshme për këto shpenzime dhe për pasojë, gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, lidhur me burimet e ligjshme të të ardhurave për krijimin e kësaj depozite.
27. Është i provuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit për faktin se si është krijuar depozita në vlerën 5.272 euro, por në asnjë rast, nuk mund të themi që kjo depozitë ka burim të ligjshëm, pasi jemi përpara faktit që subjekti ka deklaruar dy vlera të ndryshme shpenzimesh, për kurim në Gjermani. Në deklaratën e pasurisë në vitin 2010 ka deklaruar si shpenzim për kurim vlerën 10.270 euro, ndërsa në pyetësorin pranë Komisionit, vlerën 15.000 euro, ku deklaroi se diferenca mes vlerës 15.000 euro dhe 10.270 euro është paguar nga familjarët (nipërit, mbesat) për shkak të gjendjes së tij shëndetësore dhe se ai është vënë në dijeni të kësaj pagese, vetëm gjatë procesit të rivlerësimit, kur edhe i është dashur të pyesë në lidhje me këto shpenzime. Megjithatë, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë akt/zyrtar, transfertë etj., përmes së cilës të vërtetonte se diferenca, si më sipër, ishte pagur nga familjarët e tij, e për më tepër, nuk solli asnjë provë, si për t'i identifikuar ata familjarë që kishin kontribuar, ashtu edhe mbi mundësinë e tyre financiare për ta dhënë këtë kontribut. Ndodhur në këto rrethana, nisur dhe nga përgjigjet që subjekti i rivlerësimit ka dhënë në pyetësor, kjo mënyrë e të justifikuarit të kësaj pasurie, mbeti deklarative, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk përcaktoi as familjarët dhe as mënyrën se si ata kanë realizuar kontributin e tyre në këtë drejtim.
28. Referuar deklaratës së pasurisë së vitit 2011, në rubrikën e të dhënave konfidenciale dhe në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, është e deklaruar kjo depozitë, por në asnjë rast, nuk është përmendur si burim i krijimit të saj, kontributi nga familjarët.
29. *Ndodhur në këto rrethana, trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti i rivlerësimit nuk provoi burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie dhe gjendet në kushtet e deklaramit të*

*pamjaftueshëm, lidhur me burimet e ligjshme të të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie e cila bie ndesh me nenin 32, paragrafi 1, të ligjit 84/2016.*

30. Për sa i përket pretendimit të ngritur në ankim për këtë depozitë, se arsyetimi i Komisionit është sa i padrejtë dhe jo ligjor, si dhe në kundërshtim me nenin 49/1/b dhe vijues të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se vendimi i Komisionit për këtë pasuri, është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi për arsyet e përmendura më sipër.
31. Arsyetimi i mësipërm i trupit gjykues të Kolegjit u bazua në aktet shkresore të administruara në dosje, si vijon:
- i. Deklarata periodike e pasurisë për vitin 2010, ku subjekti deklaron shumën 10.270 euro si shpenzime për kurim jashtë shtetit në Gjermani.
  - ii. Nxjerrje llogarie nga “Credins Bank”, datë 28.12.2016, për gjendje në këtë datë në shumën 5.272 euro.
  - iii. Dokumentacion nga Banka Credins ku pasqyrohen lëvizjet bankare të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2008-2013.
  - iv. Deklarata e pasurisë së vitit 2011.
  - v. Deklarata e pasurisë (*vetting*) 2017.
  - vi. Përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të datës 27.12.2017, për pyetësin e Komisionit, sqarime plotësuese të përgjigjeve për këtë pyetësor, të datës 28.12.2018, përgjigjet e subjektit të rivlerësimit për Pyetësin e Komisionit, (Pyetësi - datë 06.02.2018; përgjigjet - më datë 12.02.2018).
32. **Për pasurinë:**  
*3. Apartament banimi me sipërfaqe 89.16 m<sup>2</sup>, blerë sipas kontratës së shitblerjes, nr. 5403 rep., nr. 2249 kol., datë 13.11.2013, me adresë: Rr. “{\*\*\*}”, Shk.1, Kati 2, Ap. 7, Tiranë, ZK. 8150, nr. pasurie 6/310+1-7, Vol. 49, Fq. 162. Kjo pasuri është blerë nga shitësi, shoqëria “{\*\*\*}”, sh.p.k., për shumën 73.111 euro, dhe zotërohet 100% nga personi i lidhur, znj. A.D.*
33. Referuar nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, për personat e lidhur, objektit të deklarimit të pasurisë, parashikuar nga neni 30, i ligjit nr. 84/2016, deklarimit të pasurisë, parashikuar nga neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues bëri vlerësimin e pasurisë për personin e lidhur të subjektit të rivlerësimit (vajzës së subjektit të rivlerësimit, A.D).
34. Kjo pasuri është deklaruar nga A.D për herë të parë në deklaratën e pasurisë së vitit 2009, lidhur me prenotimin e apartamentit në Rr. “{\*\*\*}”, Tiranë, sipas kontratës së porosisë mes A.D dhe Shoqërisë “{\*\*\*}” SH.P.K, në vlerën 94.000 euro. Në këtë deklaram, rezulton se është paguar vlera 40.000 euro. Sipas të dhënave konfidenciale, personi i lidhur, A.D ka deklaruar se ka marrë hua për këtë prenotim me kontratën e huas nr. 6483 rep., nr. 1556 kol., 19.11.2009, shumën 36.000 euro nga kushëriri i saj, shtetasi Sh.D.
35. Në deklaratën e pasurisë së vitit 2010, personi i lidhur, A.D deklaroi përsëri vlerën 94.000 euro të apartamentit, paguar kësti për 2010-ën, në vlerën 54.000 euro, nga të cilat 23.000 euro nga bashkëshorti i saj (G. L.), vlerën 5000 euro nga babai/subjekti Gani Dizdari, vlerën 6000 euro nga

pakësimi i gjendjes cash të deklaruar më parë dhe pjesa tjetër, në vlerën 20.000 euro, marrë hua nga kushëriri i saj, shtetasi M.L.

36. Në deklaratën e pasurisë së vitit 2010, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ka rezultuar se A.D ka përmbushur detyrimin ndaj shoqërisë “{\*\*\*}” SH.P.K, për prenotim apartamenti me kontratën nr. 11028 rep., dhe nr. 1521 kol., datë 19.11.2009, në shumën 54.000 euro, duke bërë të mundur kështu, likuidimin plotësisht të apartamentit në vlerën 94.000 euro.
37. Në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, personi i lidhur, A.D deklaroi se ka blerë nga shoqëria “{\*\*\*} sh.p.k”, me anë të kontratës së shitblerjes nr. 5403 rep., nr. 2249 kol., datë 13.11.2013, një apartament banimi me sipërfaqe 89.16 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Rr. “{\*\*\*}”, shkalla 1, kati 2, apartamenti 7, Tiranë, me numër pasurie 6/310+1-7, Zona Kadastrale 8150, volumi 49, faqe 162, në vlerën 73.111 euro, me pjesë takuese 100%.
38. Trupi gjykues i Kolegjit, referuar deklaratimeve të mësipërme të personit të lidhur, A.D, çmon të vlerësojë dhe të analizojë për këtë apartament, burimin e krijimit të këtyre të ardhurave si më poshtë:
- 38.1. Vlera 36 mijë euro, dhënë hua nga kushëriri shtetasi Sh.D, personit të lidhur për prenotimin e këtij apartamenti.*
- 38.2. Vlera prej 23.000 euro, dhënë nga shtetasi G.L(ish-bashkëshorti) i personit të lidhur A.D, deklaruar të jetë përdorur për blerjen e këtij apartamenti.*
- 38.3. Vlerën 20.000 euro, dhënë hua nga shtetasi M.L (kushëriri), personit të lidhur A.D, për blerjen e këtij apartamenti.*
- 37.1.1. Referuar deklaratimit për huan në vlerën 36.000 euro, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në dosje gjendet kontratë huadhënieje nr. 6483 rep., nr. 1556 kol., datë 19.11.2009 mes shtetasit Sh.D. dhe personit të lidhur, A.D. Data e dhënies së huas përputhet me datën e prenotimit të këtij apartamenti. Edhe vlera e kontratës është e njëjtë me vlerën e deklaruar nga personi i lidhur A.D. Kontrata e huas ka formën e duhur ligjore.
- 37.1.2. Referuar nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit parashikohet se: "*Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*", duke qenë se shtetasi Sh.D shfaqet në cilësinë e huadhënësit të personit të lidhur, A.D, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson ta cilësojë atë si person tjetër të lidhur, e për pasojë, e gjen me vend të verifikojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tij dhe aftësinë e tij për dhënien e huas, sipas paragrafit më sipër.
- 37.1.3. Referuar analizës financiare në Kolegji, për periudhën e lidhjes së kësaj kontrate huaje, personi tjetër i lidhur, shtetasi Sh.D ka pasur lëvizje bankare në vlera të konsiderueshme, kjo provuar me dokumentacionin bankar të administruar në dosjen e gjykimit.

- 37.1.4. Bazuar në shkresat zyrtare të ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për personin tjetër të lidhur, Sh.D, të ardhurat (qarkullimi) për periudhën 1995-2005 kanë qenë 13.193.100 lekë për njërin nga aktivitetet private të tij (avokatia), ndërkohë që në 3 vitet vijuese, 2006, 2007 dhe 2008, po për këtë person, Sh.D, nuk ka të dhëna nga organet tatimore që ai të ketë pasur të ardhura.
- 37.1.5. Në vitin 2009, vit në të cilin është dhënë huaja, shoqëria “{\*\*}” SHPK, në të cilën shtetasi Sh.D është ortak me 100% të kuotave, rezulton të ketë realizuar një fitim prej 40.749 lekë, por i paspërndarë ky fitim në formë dividendi.
- 37.1.6. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se nga ana e personit të lidhur A.D, por edhe nga huadhënësi, nuk u provua me dokumentacion ligjor burimi i të ardhurave për dhënien e huas, në vlerën 36.000 euro, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
- 37.2.1. *Në lidhje me vlerën 23.000 euro të dhëna nga ish-bashkëshorti G. L., trupi gjykues vëren se në dosjen e gjykimi nuk ekzistojnë dokumenta që konfirmojnë këtë marrëdhënie interesi sipas nenit 32, pika 4 të ligjit 84/2016, pra, nuk rezulton që G.L të ketë konfirmuar huadhënien dhe rrjedhimisht, personi i lidhur A.D nuk ka përmbushur detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj vlere, në kuptim të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016. Kjo përbën mospërmbushje të detyrimit për të provuar ligjshmërinë e burimit për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të nenit “D” pika 3 dhe 5, e Aneksit të Kushtetutës.*
- 37.2.2. Për sa i përket pretendimit në ankim se shuma 23.000 euro është dhënë për blerjen e apartamentit nga ish-bashkëshorti G.L., dhe se ajo ka pasur si burim punën e tij në emigracion (në Greqi), subjekti i rivlerësimit nuk e mbështeti këtë pretendim në asnjë dokument provues, e për pasojë ky pretendim mbeti në nivel deklarativ. Në këto rrethana, trupi gjykues i Kolegjit nuk mund t’i konsiderojë si të ardhura të ligjshme, në përputhje me kërkesat e nenit “D”, pika e 3, të Aneksit të Kushtetutës. Për sa më sipër, deklarimi i personit të lidhur është i pamjaftueshëm dhe në kundërshtim me ligjin.
- 38.3.1. Për sa i përket huas tjetër në vlerën 20.000 euro nga kushëriri M.L (në rastin konkret, në cilësinë e personit tjetër të lidhur), trupi gjykues vëren se akti, me të cilin personi i lidhur A.D mbështet këtë pretendim, është deklarata noteriale me nr. 4030 rep., nr. 1004 kol., datë 25.07.2011, ku M.L është në cilësinë e huadhënësit dhe A.D, në atë të huamarrëses. Kjo hua, nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se mbetet ende e pashlyer nga huamarrësja A.D. Deklarata noteriale është nënshkruar mes palëve, si më sipër në vitin 2011, pra rreth 1 (një) vit pas pagesës së plotë të çmimit të apartamentit nga A.D. Ndodhur në këtë situatë, trupi gjykues çmon se pretendimi i personit të lidhur A.D nuk është i bazuar dhe për vlerën 20.000 euro nuk provohet se është marrë nga shtetasi M.L, pasi apartamenti sipas deklarimeve ishte i likuiduar plotësisht në vitin 2010.
- 38.3.2. *Në përfundim të analizës për këtë hua, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se personi i lidhur A.D nuk provoi ligjshmërinë e burimit të krijimit të vlerës 20.000 euro dhe kjo përbën mospërmbushje të detyrimit, në kuptim të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 32,*

*pika 4, e ligjit nr. 84/2016.*

38.3.3. Lidhur me pretendimin në ankim se M.L kishte të ardhura dhe formulimi i aktit u bë një vit më pas, me kërkesën e këtij të fundit, pasi administroi aktet në dosjen e gjykimit, trupi gjykues i Kolegjit, për sa u argumentua më sipër, vlerëson se përfundimisht, ky pretendim nuk qëndron.

39. Për të tria deklaratimet e mësipërme, në cilësinë e personave të tjerë të lidhur trupi gjykues u mbështet në këto akte:

- i. Kontratë shitblerjeje, nr. 5403 rep., nr. 2249 kol., datë 13.11.2013, për apartamentin me sipërfaqe 89.16 m<sup>2</sup>, blerë 73.111 euro nga A.D;
- ii. Kontratë porosie nr. 11028 rep., nr. 1521 kol., datë 19.11.2009 për apartamentin në vlerën 94.000 euro.
- iii. Kontratë huadhënieje nr. 6483 rep., nr. 1556 kol., datë 19.11.2009 mes Sh.D dhe A.D për shumën 36.000 euro.
- iv. Deklaratë Noteriale me nr. 4030 rep., nr. 1004 kol., datë 25.07.2011 e personit të lidhur A.D, në praninë e shtetasit M.L për huan prej 20.000 euro.
- v. Procesverbal i dëshmisë së shtetasit Sh.D, i datës 22.05.2018 në zyrat e Komisionit.
- vi. Shkresa e ZVRPP Tiranë, me nr. 44777/1 prot., datë 29.12.2017 konfirmon pronësinë e znj. A.D, për pasurinë, apartament me sipërfaqe. 89.16 m<sup>2</sup>, me adresë: Rr. “{\*\*\*}”, Shk. 1, Kati 2, Ap. 7, Tiranë, ZK. 8150, nr. pasurie 6/310+1-7, Vol. 49, Fq. 162, blerë sipas kontratës së shitblerjes me nr. 5403 rep., nr. 2249 kol., datë 13.11.2013.
- vii. Shkresa e Ministrisë së Drejtësisë/Zyrës së Regjistrimit Noterial, me nr. 7643/1 prot., datë 29.12.2017, konfirmon aktin noterial të kontratës së shitblerjes, të kryer pranë noteres M.S.
- viii. Shkresa e OSHEE nr. 924/1, datë 06.02.2018, konfirmon se referuar sistemit të faturimit, identifikohen 2 kontrata në emrin e znj. A.D, njëra në adresën: Rr. “{\*\*\*}”, Pall. 5, Shk. 2, Ap 21, me datë hapje 10.10.1997, dhe tjetra identifikohet në pasurinë e ndodhur në adresën: Rr. “{\*\*\*}”, me datë hapje 06.05.2011.
- ix. Shkresë e UKT me nr. K278/1 prot., datë 06.02.2018, që konfirmon se në emër të znj. A.D rezulton e regjistruar kontrata me nr. 174751-1, për objektin me adresë: Rr. “{\*\*\*}”, Tiranë.
- x. Shkresa nr. 28165/1 prot., datë 18.12.2017 e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila informon se shtetasi Sh.D, i datëlindjes 23.12.1955, rezulton i regjistruar me NIPT {\*\*\*}.
- xi. Shkresa nr. 66439/1 prot., datë 16.01.2018 e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, e cila informon se nga verifikimi i sistemit informatik tatimor, rezulton se z. Sh. S. D., është i regjistruar me NIPT {\*\*\*}, me emër subjekti tregtar “{\*\*\*}” ({\*\*\*}), me administrator z. Sh.D, me datë regjistrimi 27.09.2010 ka

kaluar në status pasiv më datë 19.12.2014. Për periudhën deri në fund të vitit 2010, subjekti ka bërë deklarime me 0 (zero).

- xii. Shkresa nr. 67290/1 prot., datë 18.01.2018 e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.
- xiii. Shkresa nr. 67289/1 prot., datë 27.12.2017 e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, e cila informon se nga verifikimi i sistemit informatik tatimor, rezulton që z. M.L, është i regjistruar si person fizik me NIPT {\*\*\*}, me datë regjistrimi 28.06.2010. Rezulton se ky subjekt është regjistruar pranë organit tatimor pas momentit kur ka dhënë hua, për pasojë, nuk janë vlerësuar të ardhurat, pasi nuk përbën interes për procesin e rivlerësimit.
- xiv. Shkresa nr. 66440/1 prot., datë 16.01.2018 e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, e cila informon se nga verifikimi i sistemit informatik tatimor, rezulton që subjekti është i regjistruar me NIPT {\*\*\*}, me emër M.L dhe administrator M.L, me datë regjistrimi 28.06.2010.
- xv. Shkresa, nr. 5517 prot., datë 16.04.2018 e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Fier, e cila shpjegon se z. M.L, rezulton aksionar i subjektit “{\*\*\*}” Sh.P.K., me NIPT {\*\*\*}, me objekt veprimtarie: “Ndërtim i rrugëve”. Sipas të dhënave të kësaj shkrese konfirmohet se subjekti nuk ka shpërndarë asnjëherë dividend.
- xvi. Përgjigjet e pyetësorit më nr. 2574 prot., datë 19.03.2018.
- xvii. Deklarata e pasurisë e vitit 2009.
- xviii. Deklarata e pasurisë e vitit 2010.
- xix. Deklarata e pasurisë (*vetting*) 2017.

40. Lidhur me kriterin e pasurisë, personi i lidhur A.D nuk ka përmbushur detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimeve financiare edhe për krijimin e pasurive si më poshtë:

*Pagesat e qirasë mujore për apartamentin si më sipër -- vlera e pagesës mujore të qirasë ka qenë 600 euro/muaj për 5 muaj mes A.D dhe M.D. dhe 14 pagesa mujore qiraje me vlerë 500 euro/muaj me shoqërinë “{\*\*\*}” SHPK.*

41. Nga analiza e akteve në dosjen gjyqësore rezulton se këto pagesa mujore qiraje nuk janë deklaruar asnjëherë nga personi i lidhur, A.D, qoftë në deklaratat periodike, qoftë në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017.

42. Këto pagesa mujore qiraje janë përfituar nga personi i lidhur, A.D me anë të kontratës së qirasë nr. 853 rep., dhe 298 kol., datë 10.04.2012 mes A.D dhe M. D., si dhe kontratës së qirasë me nr. 1283 rep., dhe nr. 472 kol., datë 03.06.2013 mes A.D dhe shoqërisë “{\*\*\*}” SH.P.K.

43. Lidhur me pagesat e qirasë mujore, të përfituara nga personi i lidhur, A.D nëpërmjet kontratave të mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se kontrata e shkëmbimit mes saj dhe shtetasit H. C. është lidhur më datë 30.10.2013, moment në të cilin A.D nuk rezulton të ketë qenë pronare e ligjshme e apartamentit të lëshuar me qira.



44. Për të vërtetuar ligjshmërinë e të ardhurave të këtyre pagesave mujore të qirasë, trupi gjykues analizoi këto kontrata:
- i. Kontratë porosie apartamenti nr. 11028 rep., dhe 1521 kol., datë 19.11.2009, mes A.D palë porositëse dhe e porositur, shoqëria “{\*\*\*} sh.p.k”.
  - ii. Kontratë qiraje, datë 10.04.2012, me nr. 853 rep., nr. 298 kol., për apartamentin e porositur dhe të blerë në vitin 2010, i cili akoma nuk ishte shkëmbyer, mes qiradhënëses A.D dhe qiramarrësit M.D..
  - iii. Kontrate qiraje, date 03.06.2013, me nr. 1283 rep., nr. 472 kol., për apartamentin e porositur, i cili ishte blerë në vitin 2010 dhe i pashkëmbyer ende, mes A.D dhe shoqërisë “{\*\*\*}” SH.P.K.
  - iv. Kontratë shkëmbimi e apartamentit në fjalë mes A.D dhe H.C., e cila mban datën 30.10.2013. (nuk është e formuluar përpara noterit).
  - v. Kontratë shitje me nr. 5403 rep., nr. 2249 kol., datë 13.11.2013, apartamenti mes shoqërisë ndërtuese “{\*\*\*}” SH.P.K si palë shitëse dhe si palë blerëse, shtetasja A.D.
45. Në llogarinë e personit të lidhur, znj. A.D, në “Raiffeisen Bank”, gjatë vitit 2012 janë arkëtuar 5 pagesa mujore qiraje prej 600 eurosh/muaj, qira nga M. D., ndërsa për periudhën maj 2013 – qershor 2014, janë arkëtuar për 14 muaj shuma prej 500 eurosh, nga shoqëria “{\*\*\*}” sh.p.k.
46. Në qoftë se i referohemi datës së shitjes së apartamentit, të prenotuar në vitin 2009, që sipas kontratës me nr. 5403 rep., nr. 2249 kol., ka qenë data 13.11.2013, rezulton që qiraja e përfituar nga personi i lidhur, A.D ka kapërcyer këtë datë shitjeje, për rreth 7 (shtatë) muaj, deri në qershor të vitit 2014, ndërkohë që subjekti ose personi tjetër i lidhur nuk parashtroi shpjegime të arsyeshme për t’i provuar trupit gjykues përfitimet nga qiraja për një pronë, të cilën A.D nuk e gëzonte më si pronare e ligjshme.
47. Trupi gjykues vëren gjithashtu se personi i lidhur A.D nuk ka deklaruar këto të ardhura nga qiraja në asnjë deklaratë periodike. Për pasojë, trupi gjykues çmon se deklarimi i personit të lidhur nuk është i saktë dhe burimi i ligjshëm i këtyre të ardhurave mbetet i paprovuar. Si rrjedhojë, deklaratat e personit tjetër të lidhur nuk përmbush kriteret e nenit “D”, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016.
48. Për sa u përket pretendimeve në ankim se këto qira nuk janë deklaruar më parë për neglizhencë, pasi ishte në interesin e saj të deklaronte të ardhurat e përfituara në rrugë ligjore, për më tepër që nuk mund t’i fshihte, pasi aktet janë kryer përpara noterit dhe të ardhurat kanë kaluar nëpërmjet bankës në llogarinë e A.D; trupi gjykues i Kolegjit çmon se në çdo rrethanë, të ardhurat e përfitura duhet të ishin deklaruar. Të ardhurat nga qiraja kanë qenë të vazhdueshme dhe të konsiderueshme. Subjekti i rivlerësimit ka kryer detyra të një përgjegjësie dhe peshe të atillë në drejtësi që vijnë në përpjesëtim të drejtë me përgjegjësinë për të mos lejuar shpjegime të bazuara në “harresa” për pagesa të rregullta, të konsiderueshme dhe që zgjasin në kohë. Si rezultat i këtij arsyetimi, pretendimi i parashtruar në ankim nuk qëndron.

*Lidhur me vlerën 15.000 euro të përdorur për mobilim nga personi i lidhur A.D*

49. Me pyetësozin e dërguar më datë 13.03.2018, Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit në lidhje me shpenzimet për mobilimin e apartamentit të personit të lidhur, znj. A.D.
50. Subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit të datës 19.03.2018, argumenton: “Personit të lidhur, znj. A.D, mobilimi i apartamentit i ka kushtuar rreth 15.000 euro, mobilim i cili është bërë në vitin 2013”.
51. Personi i lidhur, A.D nuk ka deklaruar shpenzime për mobilimin e apartamentit në vlerën 15.000 euro në deklaratën e pasurisë të vitit 2013, si dhe nuk ka deklaruar burimin e përdorur për realizimin e këtyre shpenzimeve.
52. Sa i takon pretendimit në ankim të subjektit të rivlerësimit se burimi për realizimin e shpenzimeve të mobilimit është shuma 20.000 euro, e kthyer nga shoqëria "{\*\*\*}" SH.P.K si diferencë mes çmimit të paguar për apartamentin në Rr. "{\*\*\*}", Tiranë, në bazë të kontratës për prentim apartamenti - nr. 11028 rep., nr. 1521 kol, datë 19.11.2009 në vlerën 94.000 euro - dhe çmimit sipas kontratës së shitblerjes - nr. 5403 rep., nr. 2249 kol., datë 13.11.2013 në vlerën 73.111 euro - trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë dokument ligjor apo financiar për ta provuar.
53. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me asnjë akt kthimin e shumës 20.000 euro nga shoqëria "{\*\*\*}" SH.P.K në favor të personit të lidhur A.D, shumë përmes së cilës, kjo e fundit pretendon të ketë kryer edhe mobilimin e apartamentit. Për sa më sipër, kjo përbën mospërmbushje të detyrimit për të provuar ligjshmërinë e burimeve për krijimin e saj, në kuptim të nenit “D”, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
- Lidhur me blerjen e automjetit në vlerën 900.000 lekë nga A.D.*
54. Nga aktet e administruara në dosjen e gjykimit, rezulton se A.D ka deklaruar se burimi i fondeve për blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz” me targë {\*\*\*}, kanë qenë të ardhurat nga shitja e automjetit tjetër në pronësi të saj, tip “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*}. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se kontrata e shitjes së automjetit me targë {\*\*\*} është lidhur më datë 17.06.2013, pra, rreth 2.5 muaj më vonë nga data e blerjes së automjetit me targë {\*\*\*}, ku kontrata për këtë të fundit, është lidhur më datë 03.04.2013. Përsa më sipër, referuar analizës financiare, personi i lidhur A.D ka mungesë burimi financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë. Thëniet dhe shpjegimet e personit të lidhur bien në kundërshtim me nenin D të Aneksit të Kushtetutes dhe nenin 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016.
- Lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se automjeti është blerë në të njëjtën ditë që është shitur makina tjetër tip “Benz” që kishte në pronësi, pra, që në të njëjtën ditë de facto janë bërë likuidimet përkatëse. Gjithashtu, ai ka pohuar se kontratat kanë data të ndryshme, por kjo mund të shpjegohet me faktin se personi ka shkuar me vonesë për të firmosur kontratat dhe si rrjedhojë, edhe regjistrimi është bërë me vonesë në atë kohë.*
55. Për sa pretenduar nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë që kontratat e shitblerjes së dy automjeteve janë bërë në të njëjtën ditë dhe se likuidimi i shumave përkatëse mes

palëve është bërë në të njëjtën ditë. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit ngelën vetëm në baza deklarative.

56. Pretendimi në ankim i subjektit të rivlerësimit se personi ka shkuar më vonë për të firmosur kontratat dhe si rrjedhojë, edhe regjistrimi është bërë me vonesë në atë kohë, pa dhënë detaje konkrete dhe pa provuar me dokumentacion pretendimet e tij, nuk qëndron. Nga dokumentet që gjenden në dosje, rezulton se kontrata e blerjes së automjetit me targë {\*\*\*} është e datës 03.04.2013, ndërkohë që kontrata e shitjes së automjetit me targë {\*\*\*}, përmes të ardhurave të së cilës personi i lidhur pretendon të ketë blerë automjetin me targë {\*\*\*}, është e datës 17.06.2013, pra, rreth 2,5 muaj më vonë. Për sa më sipër, është i drejtë vendimi i Komisionit kur arrin në përfundimin se personi i lidhur ka mungesë burimi financiar të ligjshëm të të ardhurave për këtë pasuri dhe se ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në kuadër të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016.

57. *Faktet si më sipër u provuan me provat e administruara, si më poshtë vijojnë:*

- i. Shkresa me nr. 24206/1 prot., datë 12.01.2018 e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, e cila konfirmon se automjeti me targën {\*\*\*}, është në pronësi të znj. A.D.
- ii. Shkresa nr. 7643/1 prot., datë 29.12.2017 e Regjistrimit Noterial, e cila informon se rezultojnë 2 (dy) akte noteriale të hartuara tek noter Islam Hysolli, në emër të znj. A.D, përkatësisht me datë shërbimi juridik 03.04.2013 dhe akt tjetër noterial me datë shërbimi 17.06.2013.
- iii. Noteri Islam Hysolli, me shkresën protokolluar pranë Komisionit, më datë 22.01.2018, ka sjellë kontratën e shitblerjes me nr. 1601 rep., nr. 1499 kol., datë 17.06.2013, për shitjen e automjetit tip “Mercedez Benz”, me targë {\*\*\*}, në vlerën 800.000 lekë.
- iv. Kontratë blerje automjeti nr. 918 rep., nr. 843 kol., datë 03.04.2013 për blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz”, me targa {\*\*\*} në vlerën 900.000 Lekë.

58. **Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, të parashikuar nga neni 34 e vijues i ligjit nr. 84/2016** të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren:

59. *Subjekti i rivlerësimit ka pohuar përmes shkresës nr. 2574 prot.(Komisioni), datë 19.03.2018 se, citojmë: “Shtetasin A.L e kam nip, djalë motre. Me të kam marrëdhënie të mira, kam pasur dhe kam takime jo vetëm në raste familjare, por dhe në takime të veçanta sipas rastit. Me A.Ln kam udhëtuar, jashtë shtetit në Hamburg - Gjermani, fillimisht në vitin 2010 kur kam shkuar për ndërhyrje shëndetësore e më vonë, dhe 2 - 3 herë të tjera, po për arsye shëndetësore, mbasi kam pasur detyrim të bëj kontroll mjekësor për çdo vit. Theksoj se fakti që kam shkuar me nipin tim, shtetasin A.L, është se ai ka jetuar rreth 15 vite në Hamburg - Gjermani.”*

60. Gjithashtu, referuar të dhënave nga sistemi në administrim të Policisë Kufitare për të dokumentuar hyrjet dhe daljet e individëve nga pikat e kalimit të kufirit të Republikës së Shqipërisë (TIMS), të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka 10

dalje dhe 6 hyrje me automjetin e shtetasit A.L, me targë {\*\*\*}. Pronësia e shtetasit A.L mbi automjetin vërtetohet me shkresën e DPSHTR-së nr. 138/1 prot., datë 12.01.2018.

61. Kjo sa më sipër, provon faktin që subjekti i rivlerësimit ka patur dhe vazhdon të ruajë marrëdhënie të ngushta me shtetasin A.L dhe kontaktet me të nuk janë të rralla, që në kuptim të nenit 38, pika 5, germa “b”, nuk ka rrethanë lehtësuese në favor.
62. Referuar akteve shkresore të administruara nga trupi gjykues i Kolegjit, përsa i përket kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit Gani Dizdari, ka rezultuar se me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 22.06.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, lënë në fuqi me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 08.04.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë, shtetasi A.L është dënuar me vendim të formës së prerë për veprën penale të “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1, paragrafi 2<sup>1</sup> i Kodit Penal.
63. Kjo veprë penale është konsumuar nga shtetasi në fjalë për ndikim ndaj anëtarëve të Gjykatës së Lartë, në një çështje, ku kryesues i trupit gjykues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ka qenë vetë subjekti i rivlerësimit, Gani Dizdari. Megjithatë, vlen të theksojmë këtu faktin se në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 22.06.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në arsyetimin e tij, shpjegohet se, citojmë (faqe 22 e vendimit, pika 4): *“I pandehuri A.L pavarësisht premtimit që i ka bërë të pandehurit Enard, në fakt nuk ka ndikuar në trupin gjykues që gjykonte shtetasin V. M.. Shtyrja e seancave nga kolegji penal i Gjykatës së Lartë apo edhe ndryshimet e trupit gjykues, janë kryer për arsye të përligjura që ajo gjykatë i ka vlerësuar si të tilla. Kjo gjykatë nuk gjen prova bindëse, por as arsye të mendojë se shtyrja e seancave nga kolegji penal i Gjykatës së Lartë bëhej se duheshin dorëzuar shumat e kërkuara të të hollave siç pretendon akuza”*.
64. Sa i përket pretendimit në ankim se kontakti me këtë person nuk përfshihet në kategorinë e të pasurit kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar, pasi figura e veprës penale, për të cilën është dënuar ky shtetas nuk përfshihet në kategorinë e personave të parashikuar në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, (në vijim: ligji nr. 10192, datë 03.12.2009), e në këtë kuptim nuk ka pasur detyrimin të pasqyrojë një moment që nuk parashikohet nga ligji, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson si vijon:
65. Referuar nenit 3, pika 8 dhe 15 të ligjit nr. 84/2016, në momentin e dorëzimit të deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, *vepra penale, për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë shtetasi A.L, “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1, paragrafi 2 i Kodit Penal, nuk përfshihej në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, i ndryshuar, deri në atë moment vetëm me ligjin nr. 24/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, dhe në këtë*

---

<sup>1</sup> Neni 245/1, paragrafi 2 parashikon: *“Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.”*

*kuptim subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrimin të pasqyrojë në deklaratën për kontrollin e figurës një fakt që nuk parashikohej nga ligji.*

66. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vëren që me miratimin e ligjit nr. 70/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, i ndryshuar (në vijim: ligji nr. 70/2017), që ka hyrë në fuqi më datë 22.06.2017, është shtuar vepra penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, e parashikuar nga neni 245/1, paragrafi 2 i Kodit Penal, për të cilën, është dënuar me vendim të formës së prerë shtetasi A.L, kontakt i pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit sipas pohimit të bërë me shkresën nr. 2574 prot.(Komisioni), datë 19.03.2018.
67. Kjo vepër penale, tashmë përfshihet në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, i ndryshuar, e në këtë kuptim, duke qenë se vetë subjekti i rivlerësimit ka pranuar kontaktin që ka pasur dhe vazhdon të ketë me shtetasin A.L, pavarësisht se ai ishte dënuar për ushtrim ndikimi të paligjshëm ndaj trupës gjykuese, ku subjekti i rivlerësimit kishte qenë kryesues, kontakti me shtetasin A.L konsiderohet nga trupi gjykues i Kolegjit si kontakt i papërshtatshëm i subjektit të rivlerësimit bazuar në nenin 39, pika 2 dhe 38, pika 4, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.
68. *Trupi gjykues i Kolegjit, pasi bëri një analizë të hollësishme për kriterin e vlerësimit të pasurisë të subjektit të rivlerësimit, personit të lidhur dhe personave të tjerë të lidhur, pasi analizoi kriterin e kontrollit të figurës, si dhe shkaqet e ngritura në ankim nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se:*
- i. *Për kriterin e kontrollit të pasurisë*, subjekti i rivlerësimit, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me pasuritë dhe/ose të ardhurat:
    - a) *Apartament banimi, me sipërfaqe 69.7 m<sup>2</sup>, ndodhur në adresën: Rr. “{\*\*\*}”, Pall. 5, Shk. 2, Ap. 21, Tiranë, ZK. {\*\*\*}, nr. Pasurie {\*\*\*}, vol. 11, fq 209;*
    - b) *Depozitë në shumën 5272 Euro;*
    - c) *Shuma 23.000 Euro, e dhënë nga z. G.L (ish-bashkëshorti i znj. A.D);*
    - d) *Shuma 36.000 Euro, hua nga z. Sh.D;*
    - e) *Shuma 20.000 Euro, hua nga z. M.L;*
    - f) *5 pagesa mujore qiraje në shumën prej 600 Euro, qira nga M. D.;*
    - g) *14 pagesa mujore qiraje në shumën prej 500 Euro, qira nga shoqëria “{\*\*\*}” SHPK;*
    - h) *Shuma 15.000 Euro, shpenzime për mobilimin e apartamentit;*
    - i) *Autoveturë e blerë për shumën 900.000 lekë.*
  - ii. *Për kriterin e kontrollit të figurës*, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse ka kontakte të papërshtatshme me shtetasin A.L, person i përfshirë në krimin e organizuar, dhe që bën të pamundur vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, Gani Dizdari.
69. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, si i vetmi organ gjyqësor i procesit të rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë para ligjit, kushtetutshmërisë, ligjshmërisë e proporcionalitetit, parime këto që garantojnë të drejtën e subjektit të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, bazuar në konkluzionet e mësipërme, në mbështetje të neneve D, pika 3 dhe DH, pika 3 të Aneksit

të Kushtetutës, si dhe nenit 61, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 37, datë 16.07.2018 është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, mbështetur në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**V E N D O S I:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 37, datë 16.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 12.02.2019.

**ANËTAR**  
**Ardian Hajdari**  
*nënshkrimi*

**ANËTARE**  
**Rezarta Schuetz**  
*nënshkrimi*

**ANËTAR**  
**Luan Daci**  
*nënshkrimi*

**RELATORE**  
**Natasha Mulaj**  
*nënshkrimi*

**KRYESUESE**  
**Ina Rama**  
*nënshkrimi*